



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e punëve të brendshme - Ministarstvo unutrašnjih poslova
Ministry of Internal Affairs

Më 9 janar 2013

I nderuari z. Gjentillini [Gentilini],

Bashkëngjitur mund të gjeni Procedurat për ndihmë të ndërsjellë juridike, të dakorduara nga Grupi implementues për zbatimin e Prokotollit teknik për MIK më 13 dhjetor 2012.

Më lejoni që të ju shprehi konsideratat e mia më të larta.

Fisnik Rexhepi
Koordinator i Kosovës për GI MIK
[vula e MPB-së]

Procedurat për ndihmë të ndërsjellë juridike

Duke ditur që përpjekjet për mbështetjen e sundimit të së drejtës avancohen me qasje bashkëpunuese dhe në pajtim me Protokollin teknik për zbatimin e Konkluzave të dakorduara të dialogut për MIK¹, palët pajtohen të krijojnë procedura të cilat lehtësojnë procedimin e kërkesave për Ndihmë të ndërsjellë juridike (NNJ):

1. Palët do të krijojnë një kanal komunikimi për NNJ ndërmjet organeve të tyre përgjegjëse, në pajtim me juridiksionin relevant të secilës palë;
2. Fushëveprimi i kërkesave që do të barten do të përbëhet nga:
2.1 Kërkesat e përgjithshme për NNJ
3. Palët pajtohen që nga EULEX-i, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, do të kërkohet të veprojë si ndërmjetës për të ndërmjetësuar komunikimin vetëm me transmetimin e kërkesave për NNJ dhe përgjigjet e palëve për to. Palët pajtohen që EULEX-i, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, në asnjë mënyrë nuk mund të thirret në përgjegjësi për dëmet ose të jetë përgjegjës për mospajtim në zbatimin e kërkesave.
4. Teknikisht, ndërmjetësimi në komunikim ndërmjet palëve do të bëhet si vijon: organi kërkues do t'ia dorëzojë kërkesat ose përgjigjet EULEX-it, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij. Pas pranimit, EULEX-i, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, do të bashkëngjijë një shkresë përcjellëse në të cilën do të specifikohen bashkëngjijtë e kërkesës ose përgjigjes, dhe do ta bartë atë me dokumentet e bashkëngjitura të pala pranuese sipas rastit.
5. Procedurat e paraqitura nuk do të ndikojnë në detyrimet e palëve lidhur me juridiksionin relevant të zbatueshëm, traktatet ose aranzhimet e tjera në fuqi.
6. Palët do të përpiqen që të zgjidhin çfarëdo mosmarrëveshje që mund të shfaqet lidhur me pranimin, zbatimin ose realizimin e këtyre procedurave. Me ndërmjetësim të EULEX-it, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, palët do të takohen së paku një herë në vit për këtë dhe me qëllim të vlerësimit dhe përmirësimit të zbatimit të këtyre procedurave. Për më tej, me kërkesë, palët mund të takohen në çfarëdo niveli kompetent të palëve, përfshirë EULEX-in, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij. EULEX-i, në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, do të mbajë shënime zyrtare, për të cilat do të pajtohen palët.

[vula e MPB-së]

¹ Njëra palë e njeh vijën si kufi shtetëror; pala tjetër e njeh vijën si kufi administrativ.

7. Palët do të përballojnë kostot dhe shpenzimet e veta që paraqiten lidhur me pranimin, zbatimin ose realizimin e këtyre procedurave.
8. Pas konsultimit me BE-në, secila palë është e lirë të njoftojë për shkëputjen e këtyre procedurave, gjë që do zbatohet përmes njoftimit të të gjitha palëve. Shkëputja do të hyjë në fuqi tre muaj pas njoftimit.
9. Pas pranimin të këtyre procedurave me shkrim nga secila palë, BE-ja do të njoftoj palët për hyrjen në fuqi të këtyre procedurave.

[vula e MPB-së]